



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/5627/2025

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE JANAR – QERSHOR 2025

Hani i Elezit, 2025

1. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Janar 2025, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Janar 2025 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025** është në lartësi prej **3,615,457.00 Euro.**

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,188,542.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 584,500.00 €,
- Shpenzimet komunale94,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...143,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 605,415.00 €,
- Totali i buxhetit..... **3,615,457.00 €.**

Kategoritë ekonomike	Ndarjet Buxhetore Nr: 08/L-332	49 - BE - Bashkimi Evropian	Grante të mbetura	59 - Qeveria Japoneze	22 - Të hyrat e bartura	Shtesa	Total
Paga dhe shtesa	2,188,542.00					94,611.84	2,283,153.84
Mallra dhe shërbime	584,500.00	68,346.08	0.50	800.00	15,860.96		669,507.54
Shpenzime Komunale	94,000.00						94,000.00
Subvencione dhe transfere	143,000.00	-			5,000.00		148,000.00
Shpenzime Kapitale	605,415.00	107,789.37	113.18	15,123.01	149,910.71		878,351.27
Rezerva	-						-
Total	3,615,457.00	176,135.45	113.68	15,923.01	170,771.67	94,611.84	4,073,012.65

Ndërsa buxheti përfundimtar siç mund ta shohim në tabelën më lartë është **4,073,012.65 €**, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej **3,275,738.00 €**,
2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej **339,719.00 €**,
3. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024, në shumë prej **170,771.67 €**,
4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej **15,923.01 €**,
5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej **176,135.45 €**,
6. Shtesë në kategorinë buxhetore Paga dhe Shtesa, në shumë prej **94,611.84 €**,
7. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **113.68 €**.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - qershor 2025 është në shumë prej **1,758,538.44 €**.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

2. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

1. Përpilimi dhe përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për të gjitha Programet dhe Nën-Programet buxhetore, me zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas dinamikës së planifikuar për vitin 2025, nëpër të gjitha kategoritë buxhetore si: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione e transfere dhe investime kapitale.
2. Përgatitja e Raportit Fincanciar për vitin 2024 dhe e kemi dërguar për diskutim në KPF dhe Kuvend Komunal,
3. Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit të Monitorimit sipas Periudhave (Q4) në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
4. Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 dhe anekset përcjellëse si dhe dorëzimi i tyre në Departamentin e Thesarit – MFPT,
5. Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit dhjetor 2024,
6. Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve për vitin 2024 në dy formate: Word dhe PDF,
7. Publikimi i në ueb faqe komunale Raportin Financiar janar-dhjetor 2024 në 3 formate (word, pdf dhe Excel),
8. Kemi lidhur një Memorandum Mirëkuptimi me DEMOS lidhur me përmirësimin e proceseve buxhetore,
9. Hartimi i raporteve mujore për punët dhe aktivitetet e drejtorisë për çdo muaj (janar-qershor) 2025 dhe publikimi në ueb faqen Komunale në dy formate: word, pdf,
10. Hartimi i raporteve mujore për të hyrat dhe shpenzimet (janar-qershor) dhe publikimi në ueb faqe Komunale,
11. Deklarimi në Thesar obligimet e papaguara dhe kontraktuale për çdo muaj periudha (janar-qershor),
12. Fillimi i procesit të auditimit nga ZKA për PVF 2024,
13. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore,
14. Publikimi i borxhit publik çdo muaj periudha janar-qershor,

15. Hartimi i Raportit Financiar Janar-Mars 2025 dhe dërgimi i të njëjtit si informacion në KPF dhe Kuvend Komunal,
16. Hartimi i kërkesës për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025. (Dërgimi dhe miratimi në KPF dhe Kuvend Komunal).
17. Dorëzimi i kërkesës për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025 në DB-MFPT,
18. Hartimi i Raportit të Progresit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA për PVF 2023,
19. Dorëzimi i Raportit të Progresit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA për PVF 2023 në KPF dhe Kuvend Komunal,
20. Dorëzimi i Raportit të Progresit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA për PVF 2023 në Zyrën Kombëtare të Auditimit,
21. Publikimi i Raportit Financiar Janar-Mars 2025, në web faqen Komunale në 3 formate: Word, PDF dhe Excel,
22. Publikimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2024 në web faqen Komunale,
23. Përgatitja e propozimit për futjen e një projekti të ri në kuadër të buxhetit aktual të vitit 2025 si rrjedhojë e tejkallimit të projeksionit të të hyrave,
24. Pranimi i Qarkores Buxhetore 2026/01 nga Departamenti i Buxhetit – MFPT,
25. Hartimi i kalendarit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 me grupin punues dhe publikimi i njoftimeve në web faqen Komunale dhe faqja zyrtare në Facebook,
26. Hartimi i Planit të Veprimit të Dëgjimeve Buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe publikimi i njoftimeve në web faqen Komunale në dy formate: Word dhe PDF,
27. Takim me grupin punues për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
28. Hartimi i KAB 2026-2028 nga Grupi Punues,
29. Mbajtja e katër dëgjimeve buxhetore për KAB 2026-2028,
30. Plotësimi i pyetësorit nga Agjenda Evropiane, sa i përket sektorit të Buxhetit dhe Financave,
31. Pranimi i Draft Raportit të Auditimit të PVF 2024 nga ZKA,
32. Përgatitja e shkresës së rialokimit të mjeteve në kategorinë buxhetore Investime Kapitale dhe dorëzimi në KPF dhe KK për shqyrtim,

33. Përgatitja e shkresës për rritje të buxhetit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake dhe dorëzimi në KPF dhe KK për shqyrtim,
34. Hartimi dhe publikimi në ueb faqe Komunale Procesverbalet e Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2026-2028,
35. Hartimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2026-2028 dhe publikimi në ueb faqe Komunale,
36. Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit të Formularit të Monitorimit sipas Periudhave (Q1) për periudhën Janar-Mars 2025 në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
37. Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

2.1 Raport i ekzekutimit të Buxhetit periudha Janar-Qershor 2025

Kategoritë buxhetore	Buxheti 2025	Buxheti i alokuar	Realizimi Janar-Qershor 2025	% Realizim/alokim	% Realizim/planifikim
Paga dhe shtesa	2,188,542.00	1,130,352.09	1,126,876.70	99.69%	51.49%
Mallra dhe shërbime	584,500.00	669,507.54	305,061.31	45.57%	52.19%
Shpenzime komunale	94,000.00	94,000.00	46,486.86	49.45%	49.45%
Subvencione dhe trans.	143,000.00	148,000.00	106,474.68	71.94%	74.46%
Investime Kapitale	605,415.00	878,351.27	173,638.89	19.77%	28.68%
TOTAL	3,615,457.00	2,920,210.90	1,758,538.44	60.22%	48.64%

3. SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €. Inkasimi i të hyrave për periudhën Janar - Qershor 2026 nga të hyrat direkte dhe indirekte është në shumë prej 1,119,743.35 € që përfaqëson një rritje të konsiderueshme prej 561.06 % apo rritje në shumëfish prej 6.61 herë më shumë, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2024, kur është inkasuar vetëm 162,316.72 €. Kjo rritje kalon bindshëm edhe projeksionin e vitit aktual 2025 (339,719 €) dhe mund t'i atribuohet përmirësimit të efikasitetit në inkasimin e të hyrave.

Në kuadër të këtij sektori janë realizuar këto aktivitete:

- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK,
- Kemi pranuar Projeksionin e THV për vitet 2026-2028, e kemi bërë projeksionin e të gjithë llojeve të të hyrave për vitet përkatëse dhe e kemi dorëzuar në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Përmbushja e projeksionit të të hyrave vetanake në Nën-Programe dhe Kategori Buxhetore, sipas planifikimit buxhetor për vitin 2025
- Nga Divizioni i të Hyrave – MFPT kemi pranuar Raportin e të hyrave indirekte për TM1 2025, ku nga gjobat në trafik shuma e inkasuar përgjatë periudhës respektive është 16,700.00 €,
- Hartimi i kërkesës për rritje të buxhetit si pasojë e tejkalimit të projeksionit të të hyrave, miratimi në Kuvend Komunal dhe dorëzimi në Departamentin e Buxhetit – MFPT për shqyrtim të mëtutjeshëm.

4. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,
- Përfundimi i procesit të shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë nga Posta e Kosovës,
- Në Kuvend Komunal gjatë muajit shkurt, e kemi propozuar Plotësim-Ndryshimin e Vendimit mbi caktimin e normave tatimore i marrë në vitin 2024, pasi që kemi pasur një rekomandim nga Departamenti i Tatimit në pronë, për ndryshimin e preambulës së atij vendimi për arsye se pasi është miratuar në Kuvend Komunal, është plotësuar/ndryshuar/shfuqizuar një pjesë e bazës ligjore të vendimit.
- Publikimi i Njoftimit për datën e fundit të pagesës së kështit të parë të tatimit në pronë,
- Publikimi i një Njoftimi në ueb faqe dhe në faqen zyrtare në Facebook, lidhur me procesin e shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë. Departamenti i Tatimit në pronë – MFPT ka pasur probleme teknike në gjenerimin e faturave të tatimit në pronë, si rrjedhojë nuk janë printuar të gjithë faturat e tatimpaguesve të Komunës Hani i Elezit. Me ç'rast Posta e Kosovës dhe Komuna e Hanit të Elezit nuk janë përgjegjëse për këtë çështje. Andaj, kemi bërë njoftimin që ato qytetarë/tatimpagues të cilët nuk e kanë pranuar faturën e tatimit në pronë për vitin 2025 të drejtohen te Sporteli i Tatimit në Pronë, pranë QSHQ-së – kati i parë, Objekti i Komunës, në mënyrë që të pajisen me faturën përkatëse.

Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë dhe në tokë për vitin 2025 është në shumë prej 167,878.00 €. Për periudhën raportuese, nga tatimi në pronë dhe tokë kemi inkasuar të hyra në shumë prej 50,529.20 € ose 30.1% nga projeksioni.

Lindita Ballazhi – Drejtore për Buxhet dhe Financa

